



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0845**

**Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani - Kryetar, Vedat Poterqoi - Anëtar, Vjosa Gradinaj - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së OE “TALI” SH.P.K., kundër Njoftimin të kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan” me numër të prokurimit 651-23-10479-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal- Gjilan, më 27/11/2023, mori këtë:**

### **Vendim**

1. Përfundon procedura e shqyrtimit në këtë çështje administrative, për shkak të pajtimit të arritur mes palëve, Kuvendi Komunal- Gjilan nga cilësia e autoritetit kontraktues dhe Operatorit Ekonomik “TALI” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan” me numër të prokurimit 651-23-10479-2-1-1.

2. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, 5, të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkoj kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

Me 09.10.2023, Kuvendi Komunal- Gjilan në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë (NJK) dhe dosjen e tenderit (DT), për aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve në Gjilan”, evidentuar me numër të prokurimit 651-23-10479-2-1-1.

Me 18.10.2023OE "TALI" SH.P.K., nga cilësia e tij/sajë si palë e pakënaqur me vendimin e cituar ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 26.10.2023. Kurse, me 27.10.2023, "TALI" SH.P.K., ka ushtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është evidentuar me numër të protokollit 845/23.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 12.11.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Ankesa të aprovohet si e bazuar;

Te bëhen përmirësime sipas sqarimeve të dhëna me sipër dhe të vepohet konform nenit 53.7 të LPP-së.

Konstatohet paraprakisht se, raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se të dyja palët (AK dhe OE) janë në dijeni lidhur me shkresat complete të kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores për Punën e OSHP dhe se të dyja palët kanë deklaruar formalisht AK me 13.11.2023 kurse Ankuesi me 24.11.2023 se janë pajtuar me raportin e cituar si më sipër.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli konsideron se procedura e shqyrtimit përfundon në këtë fazë, në kuptim të pajtimit (marrëveshjes) së arritur të palëve dhe rrjedhimisht e njëjta ka humbur

pretendimin, respektivisht objektin ankimor sikurse kërkohet shprehimisht me dispozitën e nenit 111, të LPP. Me rastin e shqyrtimit të shkresave të kësaj lënde, natyrës dhe qëllimit të sajë, Paneli shqyrtues konsideron se palët mund ti zgjidhin raportet eventualisht kontestuese mes vete në ato raste kur ato në saje të legjislacionit, disponojnë lirisht me të drejtat e tyre. Andaj, paneli shqyrtues nuk është lëshuar fare në vlerësim të pretendimeve ankimore por vetëm nxjerrë vendim për përfundimin e procedurës.

Pajtimi i arritur mes palëve nuk bije nesh me parimet bazë dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe nuk e atakon pavarësinë institucionale të AK saj, për të zgjidhur çështjen kontestuese, meqë e lejon natyra e çështjes në rastin konkret, mes tjerash konform nenit 19 paragrafi 4 të Rregullores se Punës së OSHP-së Nr. 01/2020 (e amandamentuar).

Megjithatë, Paneli ju kujton palëve se në kuptim të nenit 19, paragrafi 4, të Rregullores për punën e OSHP parashihet se, *cituar*: “Në rast se autoriteti kontraktues dhe parashtruesi i ankesës pajtohen me raportin e ekspertit shqyrtues, paneli shqyrtues nxjerrë njoftim që autoriteti kontraktues në afat prej 5 ditësh ta implementoj raportin e ekspertit shqyrtues duke i njoftuar palët në procedurë. Për më tepër informohen palët, që ky vendim ka karakter procedural për palët në procedurë dhe në rrethana të tilla të gjeturat e këtij raporti nuk i janë nënshtruar vlerësimit nga Paneli Shqyrtues .

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues ne pajtim me nenin 105, 116 dhe 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - TALI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: